



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of Freelance Profess

Komisioni Disiplinor/ Disiplinska Komisija/ The Disciplinary Comitee

Nr.24/2019

Komisioni Disiplinor për Përmbauesit Privat, në përbërje të Alajdin Tërshnjaku kryesues, Arton Fazliu dhe Fadil I. Hoxha anëtar, procesmbajtëse Fadilete Hoxhaj-Blakçori, në çështjen juridiko-disiplinore ndaj përmbauesit privat [REDACTED] si organ përmbaues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, i dyshuar për shkelje disiplinore nga neni 9 par.1, 352 par.3, 353 par.2 dhe neni 367 par.1, nënpar.1.1, 1.2, 1.7 dhe 1.10 të LPP, në seancën dëgjimore në të cilën prezent kanë qenë: përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira Labinot Gashi, Udhëheqës i Divizionit për Jurisprudendë, Ndërmjetësim dhe Administrator Falimentues në cilësi të inicuesit të procedurës disiplinore, pala ankuese "MAB".sh.p.k e përfaqësuar nga [REDACTED] zyrtar ligjor në "MAB".sh.p.k, e në mungesë të përmbauesit privat [REDACTED] në cutesine e të dyshuarit për shkelje disiplinore, i cili ka qenë i njoftuar nga sekretaria e komisionit me rregull për kohën dhe vendin se ku mbahet sanca dëgjimore dhe, nuk ka dhënë arsytim me shkrim për mospraninë e tij në këtë seancë, pas këshillimit dhe votimit me dt:17.07.2019 me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

I.Organi Përmbaues-Përmbauesi privat [REDACTED] është përgjegjës për shkelje disiplinore nga neni 9 par.1, 352 par.3, 353 par.2 dhe neni 367 par.1, nënpar.1.1, 1.2, 1.7 dhe 1.10 të LPP, neni 3 të Udhëzimit Administrativ MD.nr.06/2014 për Traifat për Shpërblimet dhe Kompensimin e Shpenzimeve për Përmbauesit Privat si dhe nga neni 2 par.2 pika 2.3, 2.4, 2.5, 2.8 dhe 2.9 Kodit të Përkohshëm të Etikes së Përmbauesëve Privat MD-nr.07/2014.

II.Për shkeljen e kryer disiplinore, Organit Përmbaues-Përmbauesit privat [REDACTED] shqiptohet masa disiplinore gjobë në të holla në shumën 3,000.00€ në bazë të neni 368 par.1, nënpar.1.3 të LPP.

III.Organi Përmbaues-Përmbauesi privat [REDACTED] detyrohet që gjobën në të holla në shumën 3,000.00€ në emër të masës disiplinore, t'a paguaj në llogari të buxhetit të Republikës së Kosovës, bazuar në par.3 të neni 368 të LPP, në afatin pesëmbëdhjetë (15) ditë, i cili afat fillon të rrjedhë nga dita kur ky vendim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

Ar sy e t i m

Ministria e Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarrimin Privat, me dt:10.05.2019 ka paraqitur propozim për fillimin e procedurës disiplinore, ndaj përmbarruesit Organit Përmbarrues-Përmbarruesit privat ! [REDACTED], i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, si i dyshuar për shkelje disiplinore nga neni 9 par.1, 352 par.3, 353 par.2 dhe neni 367 par.1, nënpar.1.1, 1.2, 1.7 dhe 1.10 të LPP, për shkak se: përmbarruesi privat si organ përmbarrues me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbarrimore në lëndën P.nr.909/18, ka kërkuar kompensim më të lartë se ai i paraparë në tarifë sa i përket shpezimeve të përmbarrimit.

Pasi që përmbarruesi privat nuk ka marrë pjesë në seancën dëgjimore të mbajtur në hapsirat e Ministrisë së Drejtësisë, me ç'rast nga kryesuesi i komisionit para se përfaqësuesit të Ministrisë së Drejtësisë si propozues për fillimin e procedurës disiplinore të fillonte me shtjellimin e propozimit dhe provave, do t'i jepej mundësia e deklarimit për përgjegjësinë disiplinore në zbatim të par.3 të neni 7 të UA.MD.nr.9/14 për Procedurën Disiplinore ndaj Përmbarruesit Privat, komisioni bazuar në përgjigjen e dhënë me shkrim nga përmbarruesi me dt:28.05.2019, ka vlerësuar se përmbarruesi privat nuk e ndien vehten përgjegjëse për shkelje disiplinore dhe ka vazhduar më mbajtjen e seancës dëgjimore në mungesë të përmbarruesit privat.

Komisioni, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, në seancën dëgjimore të mbajtur me dt:17.07.2019, ka bërë shqyrtimin e provave përmes leximit dhe marrjes në pyetje në pajtim me nenin 7 par.5 të UA.MD.nr.09/2014.

Përmbarruesi privat në përgjigjen me shkrim të dt:28.05.2018 ndaj propozimit për fillimin e procedurës disiplinore ndaj tij, ka deklaruar se: në urdhërin për caktimin e përmbarrimit debitorit i janë caktuar shpenzime të përmbarrimit në shumën 165.52€, dhe sikur debitori do t'a paguante të njëjtën, atëherë do të përfundonte procedura përmbarrimore në këtë shumë por, për shkak se debitori ka ushtruar prapësim, shpenzimet e përmbarrimit janë shtuar rrjedhimisht në raport me veprimet e përmbarrimit, ku përveç shpenzimeve të përmbarrimit debitorit i është llogaritur edhe kamata ligjore në shumën 64.88€. lidhur me pretendimin e palës ankuese se, përmbarruesi privat vetm për veprimin përmbarrimor transferin nga llogaria e debitorit në llogarinë e veçantë të përmbarruesit privat është inkasuar shuma prej 60.00€ plus TVSH 11.80€, ka sqaruar se bëhet fjalë për tre veprime të ndërmarra nga përmbarruesi dhe për një siç pretendon pala ankuese.

Përfaqësuesi i MD-së, ka bërë shtjellimin e propozimit dhe provave, ashtu që ka deklaruar se gjithnjë sipas propozimit për fillimin e procedurës disiplinore të palës ankuese, përmbarruesi privat duke zbatuar përmbarrimin ka bërë tejkalim të tarifave dhe krijim e shpenzimeve shtesë të cilat nuk kanë të bëjnë me Udhëzimin Administrativ mbi Tarifat, për më tepër nga komisioni ka kërkuar që ti ipet fjala palës ankuese, për t'a shtjelluar tutje në detaje ankesën e vetë për shkeljet e pretenduara.

Pala ankuese në seancën dëgjimore ka deklaruar se, me pranimin e faturës dhe të pasqyrës së shpenzimeve kemi konstatuar se, se borxhi ka qenë 800.00€ ndërsa, shpenzimet së bashku me kamatën janë bërë në shumën 497.00€. Shkeljet kryesore që ne pretendojmë se na janë bërë është se përmbarruesi ka tejkaluar udhëzimin administrativ për tarifat duke arkëtuar shpenzime më shumë se sa i lejohet nga llogaria jonë në llogarinë e përmbarruesit privat. Përmbarruesi ka

ndërmarrë veprime, ka caktuar ekspert financiar për përllogaritjen e kamatës në kundërshtim me nenin 33 të Ligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit të Procedurës Përmbartimore, i cili thotë që përllogaritjen e mjeteve në bankë e bën banka dhe jo përmbartuesi, neve si debitor nuk na ka njoftuar fare, çka do të thotë se për një borxh 800.00€ na ka shkaktuar shpezime tepër të mëdha.

Komisioni, pas shqyrtimit të provave përmes leximit dhe marrjes në pyetje dhe, të gjitha shkresave që gjenden në dosjen e këtij rasti disiplinor, ka konstatuar këtë gjendje faktike: se përmbartimi në këtë çështje përmbartimore nga përmbartuesi privat është caktuar me urdhërin përmbartimor P.nr.909/18 të dt:01.12.2018 dhe, ndaj të cilit sipas deklarimeve të palës ankuese është ushtruar prapësim, nga pasqyra e shpenzimeve shihet se shuma e shpenzimeve të krijuara është 362.00€, ndërsa me urdhërin e dt:10.04.2019 konstatohet se pasi që kërkesa e kreditorit është përmbushur në tërësi përmes debitimit të llogarisë së debitorit dhe transferimit në llogari të përmbartuesit pastaj në llogari të kreditorit, procedura përmbartimore përfundohet.

Me nenin 9 par.1 të LPP është paraparë se: “Gjatë zbatimit të procedurës së përmbartimit, duhet kushtuar vëmendje mbrojtjes së dinjitetit të debitorit, dhe përmbartimi të jetë sa më pak i dëmshëm që është e mundshme për debitorët”.

Me nenin 352 par.1 të LPP është paraparë se: “Përmbartuesi privat ka të drejtë për shpërblim të punës së tij apo kompensim të shpenzimeve të shkaktuara në lidhje me punën e tij në pajtim me tarifën për shpërblimet dhe kompensimin e shpenzimeve për përmbartues privat”.

Me nenin 2 par.1 pika 2 të Kodit të Përkohshëm të Etikës së Përmbartuesëve Privat MD-Nr.07/14 është rregulluar se: “përmbartuesi privat si bartës individual i shërbimit publik e kryen shërbimin e vet me ndërgjegje, ndershtëm dhe në mënyrë të paanshme në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin. Është detyrë e përmbartuesit privat që me zbatimin e Ligjit, të akteve nënligjore, të Statutit, të akteve të përgjithshme dhe të akteve tjera të detyrueshme në procedurën përmbartimore të harmonizojnë procedurën dhe mënyrën e punës në tërë territorin e Republikës së Kosovës, në ç’mënyrë arrihet shkalla më e lartë e mundshme e sigurisë juridike/ligjore, objektivitetit dhe besimi dhe evitimi i çdo lloji të konkurrencës jolojale dhe shkaktim i dëmit në prestigjin e shërbimit përmbartimor dhe kolegëve të përmbartuesve privat. Përmbartuesi privat është i detyruar që, për të gjitha veprimet e kundërligjshme për të cilat mëson në ushtrimin punëve të përmbartuesit privat, ta njoftoj institucionin publik kompetent”, pika 2 “përmbartuesi privat është i pavarur në kryerjen e autorizimeve dhe është i detyruar që të shpreh pavarësinë dhe të veprojë në pajtim me integritetin dhe autoritetin personal dhe profesional, duke patur parasysh interesat e palëve në procedurën e përmbartimit dhe të detyrave të përcaktuara me ligj, akte nënligjore dhe me akte të përgjithshme të Odës. Zëvendësi i përmbartuesit privat është i pavarur në masën dhe sipas mënyrës së përcaktuar me Ligjin për procedurën përmbartimore, si dhe me dispozitat e këtij Kodi në pjesën që i përket përmbartuesve privat”, pika 4 thotë “përmbartuesi privat duhet të përmbahet nga sjellja e papërshtatshme, në çdo moment të veprojë në pajtim me standardet morale të profesionit të tij dhe të mbrojë prestigjin personal dhe profesional, si dhe prestigjin e profesionit” dhe, pika 5 thotë “përmbartuesi privat duhet të veprojë në mënyrën e njëjtë dhe të paanshme ndaj të gjithë personave në emër dhe dobi të të cilëve ndërmerr veprime, si dhe ndaj personave të tretë në barrën e të cilëve ndërmerren veprimet”.

Me nenin 367 par.1 pika 1.1 dhe 1.2 të LPP është paraparë se, shkeljet disiplinore ndër të tjera mundën të jenë: “nëse përmbartuesi privat tejkalon autorizimet e besuara me këtë ligj; nëse

gjatë kryerjes së veprimeve në kuadër të aktivitetit të tij përbaruesi privat nuk i përmbahet ligjit”.

Komisioni, pas vlerësimit të provave të shqyrtura përmes leximit dhe marrjes në pyetje në këtë çështje disiplinore, në seancën për këshillim dhe votim me shumicë votash ka ardhë në përfundim se, përbaruesi privat si në hyrje ka kryer shkelje disiplinore në këtë çështje përbarimore, për shkak se gjatë ndërmarrjes së veprimeve përbarimore si mjete të përbarimit nuk i është përmbajtur ligjit, rrjedhimisht ka ndërmarrë veprime përbarimore jo në përputhje me dispozitat e LPP-së me të cilat rregullohet kjo procedurë, për pasojë ka cënuar parimet themelore të përcaktuara me Kodin e Përkohshëm i Etikës së Përbaruesëve Privat MD-Nr.09/2014.

Komisioni, ka gjetur se organi përbarues-përbaruesi privat, nuk ka treguar kujdesin e duhur ashtu siç kërkojnë dispozitat e sipërcituara, për shkak se veprimet përbarimore i ka ndërmarrë jo në përputhje me këto dispozita. Përbaruesi privat, kë bërë shkelje disiplinore kur me rastin e caktimit të përbarimit me urdhërin përbarimor P.nr.909/18 të dt:01.10.2018, ka përfshirë shpenzime në mënyrë të përgjithësuar për veprime përbarimore që do të ndërmerren në të ardhmen pra, e ka paragjykuar epilogun e rrjedhës së kësaj çështje përbarimore, për shkak se sipas nenit 3 të UA-MD.nr.06/2014 përbaruesi privat për veprimet e kryera arkëton shpërblimin dhe kompensimin e shpenzimeve tjera pra, sipas kësaj dispozite nuk mund të arkëtohen e as të hyjnë në urdhërin për caktimin e përbarimit shumëmat për shpërblimet për veprime që ende nuk janë ndërmarrë por, ato caktohen atëherë kur veprimi përbarimor ndërmerret.

Komisioni, shkelje disiplinore e ka vlerësuar veprimin e përbaruesit kur, në urdhërin për caktimin e përbarimit, si shpenzime të procedurës ka caktuar edhe tarifën në efikasitet në shumën 70.80€, në kundërshtim nenin 40 par. Të UA-MD.nr.09/2014, për shkak se me këtë dispozitë është thënë: “Tarifën e performancës e cila varet nga efikasiteti i zbatimit të përbarimit siç është paraparë në Tabelën 1, përbaruesi privat do ta arkëtoj nga debitori pas kryerjes së veprimit përbarimor”, pra sipas kësaj dispozite varësisht prej performancës-suksesit të organit përbarues në realizimin e kërkesës së kreditorit të përbarimit, do të inkasohet tarifa në efikasitet si shpërblim dhe jo si shpenzim procedural dhe, ende pa u realizuar asnjë pjesë nga kërkesa e kreditorit të përbarimit.

Komisioni, shkelje disiplinore e ka vlerësuar veprimin e përbaruesit për përpilimin e përgjigjes në prapësim dhe inkasimin e shumës 40.00€ për këtë veprim, për shkak se me këtë veprim është cënuar parimi i paanshmërisë nga përbaruesi privat i paraparë me nenin 2 par.2.5 dhe 8 të Kodit të Përkohshëm të Etikës për Përbarues Privat MD-NR.7/2014 i cili thotë se: “përbaruesi privat duhet të veprojnë në mënyrë të njëjtë dhe të paanshme ndaj të gjithë personave në emër dhe dobi të të cilëve ndërmerren veprime, si dhe ndaj personave të tretë në barrën e të cilëve ndërmerren veprimet” si dhe parimi i papajtueshmërisë i cili thotë se: “Përbaruesi privat duhet të përmbahet nga kryerja e punëve dhe të funksioneve të cilat janë të papajtueshme me punët e përbarimit, siç janë kryerja e funksioneve publike, të funksioneve administrative apo kontrolluese në shoqëritë tregtare, kryerja e punëve të sigurimit, ushtrimi i profesionit të avokaturës dhe të profesioneve tjera gjyqësore, si dhe të punëve tjera të cilat janë të papajtueshme apo mund të dëmtojnë prestigjin e profesionit të përbaruesve” pra, përbaruesi duhet t’a kryejë vetëm funksionin e përbaruesit privat.

Komisioni, sjellje të papërgjegjshme dhe jo të mirë e ka vlerësuar edhe mos dërgimin e shkresave të kësaj çështje përbarimore, sipas kërkesës së Sekretarisë së Komisionit Disiplinor përmes komunikimit elektronik të dt:23.04.2019, si dhe mos pjesëmarrjen në seancën dëgjimore sepse, me neni 2 par.2.9 të Kodit të Përkohshëm të Etikës për Përmbaues Privat MD-NR.7/2014 thotë: “Përmbauesi privat është i detyruar që gjykatës, ministrisë kompetente, dhe organeve tjera të administratës shtetërore dhe institucioneve publike, si dhe organeve të Odës t’iu sigurojë të gjitha të dhënat për punën e vet në pajtim me ligjin dhe aktet e tjera të përgjithshme” pra, përmbauesi privat duke mos dërguar shkresat e lëndës përbarimore kë bërë shkelje edhe të kasaj dispozite të Kodit të Përkohshëm të Etikës për Përmbaues Privat MD-NR.7/2014, me të cilën rregulluar sjellja e përmbauesit privat gjatë kryerjes së punës publike në raport me Institucionet e Shtetit.

Komisioni në bazë të asaj që është sqaruar më lart, ka vlerësuar se masa disiplinore e shqiptuar është e mjaftueshme tani për tani dhe, se do kjo masë do ti shërbej përmbauesit si organ përmbaues në këtë çështje përbarimore, si dhe përmbauesëve të tjerë që t’u përmbahen me përpikëri dispozitavë ligjore, nënligjore dhe Kodit të Përkohshëm të Etikës së Përmbauesëve Privat gjatë zbatimit të përbarimit në secilën çështje përbarimore që do të paraqitet para tyre për përbarim dhe, që të jenë më të kujdeshëm, ashtu që të ndërmerren vetëm veprime të domosdoshme në drejtim të zbatimit të përbarimit, me qëllim që përbarimi të jetë sa më pak i dëmshëm që është e mundshme për debitorin e përbarimit.

Bazuar në nenin 9 par.1, 352 par.3, nenin 353 par.2, nenin 367 par.1 nënpar.1.1, 1.2, 1.7 dhe 1.10 të LPP, nenit 2 par.2 pika 2, 3, 2.4, 2.5, 2.8 dhe 2.9 të Kodit të Përkohshëm të Etikës së Përmbauesëve Privat dhe, nenin 3 të Udhëzimit Administrativ MD.nr.06/2014 për Tarifat për Shpërblimet dhe Kompensimin e Shpenzimeve për Përmbauesit Privat dhe, mbi bazën e asaj që është thënë më lart, komisioni vendosi si në dispozitiv.

**Komisioni Disiplinor për Përmbauesit Privat
Nr.24/2019; dt:17.07.2019**

**Kryetari i Komisionit Disiplinor:
Alajdin Tërshnjaku**



Këshillë juridike: Vendimi i Komisionit Disiplinor për Përmbauesit Privat është përfundimtar. Kundër vendimit të komisionit disiplinor mund të ngritët konflikti administrativ bazuar në par.5 të nenit 374 të LPP-së.